

Nr. Prot. 009/B/15

VENDIM Nr. 595

Për

Përcaktimin e tarifave të Qasjes dhe thirrjeve (Kombëtare dhe Ndërkombëtare) në rrjetin publik telefonik fiks të operatorit, PTK Sh.A.

Në mbështetje të neneve; neni 1, neni 3, nenit 10, paragrafi 5) dhe 7), neni 32, neni 36, neni 37, neni 40, paragrafi 4), neni 79, paragrafi 2) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si - Ligji*); dhe në referim të nenit 20 të Rregullores së Brendshme (Ref. Nr. Prot. 161/06) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i ARKEP i përbërë nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj Anëtar
- 4) z. Naser Shala Anëtar
- 5) z. Nijazi Ademaj Anëtar

në mbledhjen e LXV) me radhë të mbajtur më datë; 27 Janar 2015, bazuar në shqyrtimin e materialeve të përgatitura dhe prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) lidhur me operatorin PTK Sh.A., Njësa e Telekomit/Telefonisë Fikse (TiK) në referim të çështjes mbi implementimin e detyrimeve të dala nga procesi i analizës së tregut të telefonisë fikse, të parapara me dispozitat e legjislacionit primar të referuar si më lartë, respektivisht bazuar në dispozitat e legjislacionit vijues sekondar;

- i. Vendimit Nr. 505 për Auditimin e Sistemit të operatorit PTK Sh.A. lidhur me kontrollin e çmimeve dhe llogaritjen e kostos sipas metodës së shpërndarjes së plotë të kostos (Ref. Nr.Prot. 019/B/14 dt: 19 Qershor 2014), pika III).
- ii. Vendimet për përcaktimin e operatorit, PTK Sh.A. me fuqi të ndjeshme në tregjet relevante, të datës; 29/02/2012 {Nr. 180, 181 dhe 182 (Ref. Nr. Prot. 025/B/12),- *tutje referuar Vendimet për OFNT*}.
- iii. Rregullores Nr. 15 për llogaritje të kostos sipas metodës së shpërndarjes së plotë të kostos (Fully Distributed Cost – FDC), të datës 22/06/2012 (Ref. Nr.Prot. 043/B/12; *tutje referuar si – Rregullorja për FDC*).
- iv. Rregullores Nr. 27 për analizat e tregut, të datës 23/12/2014 (Ref. Nr.Prot. 040/B/14).

Atëherë, Bordi i ARKEP, vendosi si më poshtë;

V E N D I M

- I. Përcaktohet pragu minimal i tarifës (pa TVSH) për ofrimin e Qasjes në rrjetin publik telefonik në lokacion fiks për operatorin PTK Sh.A. prej **3.43 €**.
- II. Përcaktohet pragu minimal i tarifave (me TVSH) për ofrimin e shërbimeve të thirrjeve lokale/kombëtare dhe atë;
 - a) *Thirrjet brenda rrjetit (on-net);* **1 euro cent**
 - b) *Thirrjet off-net drejt rrjeteve tjera fikse;* **5.4 euro cent**
 - c) *Thirrjet drejt rrjeteve mobile;* **9 euro cent**
- III. Përcaktohet pragu minimal i shërbimeve të thirrjeve ndërkombëtare bazuar në modelin e zvogëlimit të përshkallëzuar (*Glide path*), përkatësisht tarifat për thirrjet ndërkombëtare;
 - a) *Duhet të ulën për 20% me efekt brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;*
 - b) *Kurse ulja prej 20% shtesë do të përcaktohet me vendim të veçantë nga Autoriteti.*
- IV. Derisa PTK Sh.A. të vërtetojë pranë ARKEP se çmimet për këto shërbime janë të bazuara në kosto, PTK Sh.A. duhet të sigurojë se këto çmime nuk duhet të jenë më të ulëta se çmimin e përcaktuar me pikat I), II) dhe III) të këtij vendimi.
- V. Obligohet PTK Sh.A. që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi të aplikojë tarifat e përcaktuara nga pika I), II), dhe III) dhe t'i publikojë në ueb faqen e saj.
- VI. Obligohet PTK sh.A. që brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi të aplikojë sistemin e tarifimit për thirrjet (*të përcaktuara në pikat II dhe III të këtij vendimi*) të bazuara në minutë, përkatsisht minuta e parë të tarifohet e plotë, ndërsa pjesa tjetër në sekond.
- VII. Ky vendim është i formës së prerë dhe hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Analiza e tregjeve të telefonisë fikse është iniciuar me vendimin Nr. 58 të Bordit për 'Analizën e Tregut të Telefonisë Fikse' të datës; 31/01/2011 (Ref. Nr. Prot. 002/B/11), i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin Nr. 128 të datës; 13/09/2011 (Ref. Nr. Prot. 051/B/11).

Sipas vendimeve të referuara më lartë, tregjet e analizuara janë;

- 1) Qasjen në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse;
- 2) Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fikse;
- 3) Shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fikse;
- 4) Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruara në një lokacion fikse;
- 5) Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fikse;
- 6) Shërbimet transite në rrjetet publike telefonike fikse;
- 7) Qasjen me shumicë në Infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë qasjen e ndarë, të pjesshëm dhe të plotë) për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.

Analiza e tregjeve të specifikuar si më lartë ka treguar se konkurrenca nuk është efektive dhe si rezultat operatori PTK Sh.A. është përcaktuar si Ofrues me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT) në të gjitha tregjet e analizuar, respektivisht;

1) Tregjet me pakicë (gjithsej 3);

- Qasja dhe thirrjet (nacionale dhe ndërkombëtare) në rrjetin fikse {Ref. Vendimet; Nr. 180 (Nr. Prot. 018/B/12), Nr. 181 (Nr. Prot. 019/B/12), Nr. 182 (Nr. Prot. 020/B/12)};

2) Tregjet me shumicë (gjithsej 4);

- Interkoneksioni, respektivisht Origjinimi, tranzitimi dhe terminimi {Ref. Vendimet; Nr. 183 (Nr. Prot. 021/B/12), Nr. 184 (Nr. Prot. 022/B/12), Nr. 186 (Nr. Prot. 024/B/12)}; dhe
- Qasjen me shumicë të infrastrukturën e rrjetave fizike (Ref. Vendimi Nr. 187 me Nr. Prot. 025/B/12).

PTK Sh.A. e përcaktuar me FTN, është obliguar që të zbatojë masat rregullatore të specifikuar në rregulloren për analiza të tregut, respektivisht neni 6, si në vijim;

- 1) Obligimi i Qasjes
- 2) Obligimi për mos-diskriminim
- 3) Obligimi i transparencës
- 4) Obligimi për kontrollin e çmimeve
- 5) Obligimi për ndarjen e llogarive
- 6) Obligimi për mos-subvencionim të tërthortë

Pas përfundimit të këshillimit publik, dhënies së sqarimeve të nevojshme nga ARKEP në të gjitha fazat e këtij procesi, si dhe shtyrjes së afatit për përmbushjen e obligimeve me Vendimin Nr. 232 (Ref. Nr. Prot. 047/B/12), operatori PTK Sh.A. ka dorëzuar dokumentet e kërkuara nga ARKEP; **Ofertat referente (RIO dhe RUO) dhe Kontratën Standarde për ofrimin shërbimeve të qasjes.**

Duke pasur parasysh faktin se gjatë procesit të shqyrtimit të draft ofertave referente, është vërejtur se ato përmbushin detyrimet rregullatore, atëherë janë krijuar kushtet që të fillohet me implementimin e obligimit për 'llogaritje të kostos', siç është paraparë me Vendimet për OFNT dhe Rregulloren për FDC.

Së këndejmi, me Vendimin Nr. 379 (Ref. Nr. Prot. 023/B/13), ARKEP ka obliguar operatorin PTK Sh.A. që të përmbush këtë detyrim dhe deri më datën; 10 Dhjetor 2013 të dorëzoj të gjithë dokumentacionin përkatës që vërteton se PTK Sh.A. ka implementuar detyrimin e llogaritjes së kostos së bashku me rezultatet (*kostot e shërbimit*).

Më datë; 10 Dhjetor 2013 në afatin e paraparë me aktvendimin e referuar si më lartë, PTK Sh.A. ka dorëzuar raportin mbi modelin e kostove fikse të PTK Sh.A. (Ref. Nr.Prot. 836/2/13).

Pas shqyrtimit të raportit dhe prezantimit të tij nga përfaqësuesit e PTK Sh.A. në takimin e zhvilluar me zyrtarët e ARKEP, duke përfshi këtu edhe të dhënat shtesë të dërguara më datë; 29 Prill, 2014 (Ref. shkresa/e-maili April 29, 2014 12:51 PM), është vërejtur se përkundër angazhimit të operatorit në përmbushjen e këtij detyrimi, raporti është vlerësuar si raport i përmbledhur dhe sipërfaqësor dhe si i tillë me mangësi të theksuara në një numër të konsiderueshëm të të dhënave, të cilat do të duheshin të përfshiheshin në raport.

Prandaj, ARKEP konsideron që PTK Sh.A. i ka bërë hapat elementar të krijimit të sistemit të FDC, mirëpo i njëjti ende mbetet i paqartë pasi që nuk është mjaftueshëm i detajuar apo dokumentuar ashtu që të mund të vlerësohej siguria dhe paanësia e sistemit të llogaritjes së kostos dhe nxitësve të përdorur të kostos.

Gjatë shqyrtimit të tarifave të propozuara nga PTK Sh.A., ARKEP ka konstatuar se përkundër faktit që operatori PTK Sh.A. ka përmbushur detyrimin rregullator për dorëzimin e raportit mbi implementimin e obligimit të llogaritjes së kostos sipas modelit FDC (Ref. Nr.Prot.836/2/13 së bashku me të dhënat shtesë të dërguara më datë; 24 Mars 2014, e-mail: 1:18 PM), megjithatë nuk ka arritur që të jap një arsytim të plotë të çmimeve të vendosura nga PTK Sh.A.

Së këndejmi, ARKEP me vendimin Nr. 505 (Ref. Nr.Prot.019/B/14) ka obliguar operatorin PTK Sh.A. që të bëjë auditimin e sistemit të shpërndarjes së kostos nga auditori i pavarur i jashtëm. Më tutje, Vendimi në fjalë (pika III) përcakton se;

'Derisa të vërtetohet se çmimet për tregjet e analizuara janë të bazuara në kosto, ARKEP do të aplikoj metodën krahasimore për tregjet e analizuara'.

Po ashtu edhe vendimet për OFNT të specifikuara më lartë, përcaktojnë se ARKEP mund të vendos çmimet duke përdorur metoda tjera (*p.sh. benchmarking, retail minus, modelet bottom up, etj.*).

Më datë; 17 Nëntor 2014 Autoriteti ka dërguar shkresë (Ref. Nr. Prot. 977/2/14), përmes së cilës ka kërkuar nga operatori PTK Sh.A. dhënien e komenteve në propozimet e bëra nga Autoriteti (të bazuara në metodologjinë krahasimore) për tarifën e shërbimeve për tregjet me pakicë për tregjet si në vijim;

- 1) Qasjen në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse;
- 2) Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fikse;
- 3) Shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fikse;

- 4) Qasjen me shumicë në Infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë qasjen e ndarë, të pjesëshëm dhe të plotë) për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.

Qasja: Lidhur me tarifën për qasjes në rrjetin publik telefonik fiks (tarifa e mirëmbajtjes mujore) nga të dhënat në tabelën 5 vërehet se përderisa PTK aplikon tarifë prej 3.43 €, e njëjta në vendet e rajonit (me përjashtim të Shqipërisë) është mbi 5 €. Pra, tarifa e PTK është mbi 30% me e ultë se sa tarifat e njëjta të cilat aplikohen në vendet e rajonit.

Tabela 1: Tarifat e mirëmbajtjes mujore (Pa TVSH)

Shteti	Tarifa e mirëmbajtjes mujore
BG	5.11
HR	7.9
MK	6.49
MT	5.08
ME	5.1
AL ¹	4.18
RKS	3.43
EU-27	15.36

Thirrjet lokale/kombëtare dhe ndërkombëtare: Në tabelën në vijim janë paraqitur krahasimet e tarifave për thirrjet kombëtare nga rrjeti i telefonisë fikse të PTK Sh.A me vendet e rajonit.

Tabela 2: Tarifat e thirrjeve Kombëtare (Me TVSH)

Tarifat e thirrjeve kombëtare	Koha e aplikimit	Brenda rrjetit		tjera fikse		Mobil	
		lokale	kombëtare	lokale	kombëtare	Pjesë e grupit/ Kompanisë	mobil
PTK	Peak	0.010	0.010		0.051	0.09	0.16
	Off Peak	0.010	0.010		0.026	0.04	0.16
Alb telekom	Peak	0.022	0.032	0.050	0.0727	0.054	0.187
	Off Peak	0.018	0.028			0.229	0.143
Makedonski Telekom	Peak	0.019	0.019		0.019		0.114
	Off Peak	0.012	0.012		0.012		0.065
Cernogorski Telekom	Peak	0.016	0.038		0.059		0.165
	Off Peak	0.009	0.021		0.059		0.095

Nga të dhënat në tabelën 2 vërehet se tarifat e thirrjeve lokale/kombëtare brenda rrjetit (*on-net*) janë dukshëm më të ulëta (rreth 50%) krahasuar me vendet e rajonit. Po ashtu edhe tarifat kombëtare drejt rrjeteve tjera fikse dhe mobile (*off-net*) janë më të ulta se në vendet fqinje në mbi 14% (në fikse), përkatësisht 12% (në rrjetet mobile), me përjashtim të Maqedonisë, e cila aplikon

¹ *ALB Telekom në kuadër të tarifës për mirëmbajtje në orët e off pikut (20:00-08:00) ofron thirrje pa limit brenda rrjetit dhe drejt rrjetit mobil Eaglemobile, thirrje ndërkombëtare 60 minuta/muaj Internet 1GB Internet/muaj. Në bazë të vendimit 271 AKEP ka hequr obligimet për kontroll të çmimeve në tregjet me pakice për Albtelekom.

tarifa uniforme për thirrjet on-net dhe off-net në rrjetet fikse përkatësisht rreth 28.7% me lirë për thirrjet drejt rrjeteve mobile.

Sa i përket tarifave të thirrjeve ndërkombëtare, nga të dhënat në tabelen 3 vërehet se janë dukshëm më të larta se ato të shteteve rajonale, të cilat në disa raste në mbi 200% më të larta.

Tabela 3: Tarifatat e thirrjeve ndërkombëtare (Me TVSH)

Tarifat e thirrjeve kombetare	Koha e aplikimit	Kosovë		Shqipëri		Maqedoni		Mal të Zi		Gjermani		Itali		Francë		Mbretëri e Bashkuar		SHBA		Kanada	
		Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.	Fiks	Mob.
PTK	Peak			0.26	0.41	0.26	0.41	0.26	0.41	0.32	0.47	0.32	0.47	0.32	0.47	0.32	0.47	0.38	0.53	0.38	0.53
	Off Peak			0.13	0.28	0.13	0.28	0.13	0.28	0.16	0.31	0.16	0.31	0.16	0.31	0.16	0.31	0.19	0.34	0.19	0.34
Alb Telekom	Peak	0.11	0.27			0.11	0.27	0.11	0.27	0.11	0.27	0.11	0.27	0.11	0.27	0.11	0.27	0.11	0.11	0.11	0.11
	Off Peak	0.08	0.20			0.08	0.20	0.08	0.20	0.08	0.20	0.08	0.20	0.08	0.20	0.08	0.20	0.08	0.08	0.08	0.08
T mobile Makedonski Telekom	Peak			0.25	0.54			0.25	0.54	0.23	0.75	0.19	0.75	0.19	0.75	0.19	0.75	0.19	0.19	0.19	0.19
	Off Peak																				
T mobile Cernogorski Telekom	Peak	0.13		0.13		0.13				0.18		0.18		0.18		0.18		0.10		0.10	
	Off Peak																				

Më datë; 24 Nëntor 2014 operatori PTK/TiK ka dërguar në ARKEP komentet (*Ref. Nr.Prot. 1011/2/14*), të cilat janë paraqitur në dokumentin e konkluzioneve së bashku me përgjigjet e Autoritetit.

Prandaj, duke pasur parasysh arsyetimin e shpalosur si më lartë si dhe me qëllim të;

- i. implemtimit të detyrimit për kontrollin e çmimit dhe llogaritjen e kostos, transparencë dhe mosdiskriminim nga PTK Sh.A, detyrime këto të përcaktuara me Vendimet e referuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi;
- ii. krijimit të kushteve për një konkurrencë efektive në tregjet e telefonisë fikse;
- iii. ofrimit të shërbimeve me çmime më të arsyeshme për përdoruesit fundor;

Atëherë, Bordi i Autoritetit ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

Prishtinë, 13/02/2015

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- Operatorit PTK Sh.A./TiK
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK)
- Arkivit të ARKEP